



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova /
Ministry of Internal Affairs*

Departamenti për Siguri Publike / Department za Javni Bezbednost / Department for Public Safety
Divizioni për Sigurinë e Aviacionit Civil / Divizija za Bezbednost Civilne Avijacije / Division for Civil Aviation Security

LISTA E ARTIKUJVE TË NDALUAR

Pasagjerët dhe bagazhi i kabinës (dorës)

Pa rënë ndesh me rregullat e zbatueshme të sigurisë në operim (safety), pasagjerët nuk lejohen të mbartin artikujt e mëposhtëm në zonat e kufizuara të sigurisë dhe në bordin e një aeroplani:

- a) armë, armë zjarri dhe pajisje të tjera që shkarkojnë predha - pajisje të afta, apo të dukshëm të afta, për t'u përdorur për të shkaktuar lëndime serioze duke shkarkuar një predhë, duke përfshirë:
- armë zjarri të të gjitha tipeve, të tilla si pistoleta, revolverë, pushkë të gjata të rënda, pushkë gjahu;
 - armë lodër, kopje dhe imitime të armëve të zjarrit që mund të merren gabimisht si armë të vërteta;
 - pjesët përbërëse të armëve të zjarrit, duke përfshirë ato për pamje teleskopike;
 - armët me ajër të kompresuar dhe armë me CO₂, të tilla si pistoleta, saçme armësh, municion për armë dhe pushkë të gjata;
 - pistoleta të sinjalizuese dhe pistoleta për nisje të garave sportive;
 - harqet, harqet kryq dhe shigjetat;
 - armë me fuzhnjë dhe armë me shtizë;
 - llastiqe dhe katapulta.
- b) mjete trullësëse - pajisjet e projektuara posaçërisht për të trullësuar ose për të penguar lëvizjet, duke përfshirë:
- pajisje goditje, të tilla si armë trullësëse elektrike, pistoleta paralizuese dhe shkopinjtë gome;
 - mjete që trullojnë qeniet e gjalla dhe vrasës të qenieve të gjalla;
 - kimikate që ndikojnë në paaftësimin e kundërveprimit, gazra dhe spërkatës,
 - të tilla si spërkatësit që shkarkojnë lot, dhimbje, qorrime, spërkatësit me piper, spërkatës i lëng të prodhuar nga farat e specave djegëse, gaz lotsjellës, spërkatjet e acidit dhe spërkatës kundër insekteve.

- c) objekte me një majë të mprehtë ose buzë të mprehtë - objekte me një majë të mprehta ose buzë të mprehta të aftë për t'u përdorur për të shkaktuar lëndime serioze, duke përfshirë:
- artikujt e projektuar për të prerë, të tilla si sëpata, sëpata luftimi dhe hanxharë;
 - patina akulli dhe akull thyese;
 - brisk rroje;
 - hapëse kutish;
 - thika me tehe prej më shumë se 6cm;
 - gërshërë me tehe më shumë se 6cm të matura nga boshtet;
 - pajisjet e arteve marciale me majë të mprehta ose një buzë të mprehtë;
 - kama dhe shpata kalorësish.
- d) veglat e punës - mjete të afta për t'u përdorur ose për të shkaktuar lëndim serioz ose të kërcënojnë sigurinë në operim (safety) të aeroplanëve, duke përfshirë:
- levat;
 - trapan dhe puntot e trapanit, duke përfshirë trapanët portative të lëvizshme pa tela;
 - vegla me brisk ose një shigjetë prej më shumë se 6cm që mund të përdoren si armë, të tilla si kaçavida dhe daltë;
 - sharra, duke përfshirë sharrat e lëvizshme pa tela;
 - pipëza saldimi;
 - vegël për monitorimin e dyerve dhe pajisje për shtyrjen e gozhdëve.
- e) instrumente të mprehta - objekte që mund të përdoren për të shkaktuar lëndime serioze kur përdoret për të goditur, duke përfshirë:
- shkopinj bejsbolli;
 - shkop golfi dhe shkop polici dhe stekat e bilardos;
 - pajisjet e arteve marciale.
- f) eksplozivët dhe substancat ndezëse - substance eksplozive dhe substancave ndezëse dhe pajisjeve të aftë, ose që duken të afta, për të shkaktuar lëndime serioze ose për të paraqitur një kërcënim për sigurinë e aeroplanit, duke përfshirë:
- municione;
 - kapak shpërthimi;
 - detonatorë dhe fitila;
 - falsifikime ose imitim të materialeve shpërthyes;
 - mina, granata dhe pajisje të tjera ushtarake shpërthyes;
 - fishekzjarrë dhe ndezës të tjerë;
 - fishekë që krijojnë tym;
 - dinamit, barut dhe eksplozivë plastikë.

Bagazhi për depo të aeroplanit

Pasagjerët nuk lejohen të mbajnë në bagazhin e tyre të depos artikujt e mëposhtëm:

Eksplozivë, pajisje dhe substanca të djegshme - eksplozivë dhe substance e djegshme ne gjendje dhe pajisje të afta që vihen në përdorim për të shkaktuar lëndime serioze ose që paraqesin kërcënim për sigurinë e operimit (safety) të aeroplanit, përfshirë:

- municion;
- kallëp shpërthyes;

- detonatorë dhe (fital) çelës shpërthyer;
- mina, granata dhe të tjera magazinime ushtrake shpërthyes;
- fishekzarrë dhe të tjera piroteknike;
- tymëse në kuti dhe në enë cilindrike;
- dinamit, barut dhe lëndë shpërthyes plastike.